

Burime brenda Ministrisë së Brendshme konfirmojnë se shtatë oficerë policie nga Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë RENEA's janë shkarkuar nga puna se i përkasin besimit musliman.

Shtatë punonjësit e policisë ishin besimtar mysliman dhe praktikan të fesë. Ata falshin pesë herë në ditë në xhami dhe kjo nuk është toleruar nga shefat e policisë që sot kanë marrë masën ekstreme të largimit nga detyra.

Ndërkohë që debati fetar është ndezur në Shqipëri për shkak të refuzimit të ambasadorit musliman Visar Zhiti në Vatikan si dhe kërkesave të kishës ortodokse për kuotim të emërimeve në administratë vjen kjo fushatë reprezaljesh kundër besimtarëve musliman kur dihet fare qartë që kryeministri dhe zv/kryeministri shqiptar të dy i përkasin besimit të krishterë /opozita.com/